HOROSKOPI

Kronikë

Kapen me pistoletë dhe municion luftarak në makinë, dy të arrestuar në Vlorë (EMRAT)

Jurges Gurthi dhe Egent Alku, përkatësisht 27 dhe 45 vjeç, janë arrestuar nga policia e Vlorës pasi janë kapur duke udhëtuar me armë në makinë

Balla bën 'bilancin': 29 të arrestuar e të vënë në hetim në kuadër të operacionit 'Tempulli' e 'Sundimi i Ligjit'

Redaksia
30 Nëntor, 09:16 | **Përditësimi: 30 Nëntor, 11:23**

Share

Jurges Gurthi dhe Egent Alku, përkatësisht 27 dhe 45 vjeç, janë arrestuar nga policia e Vlorës pasi janë kapur duke udhëtuar me armë në makinë.

Arrestimi i tyre u krye në kuadër të operacionit 'Strike'. Ata u ndaluan teksa udhëtonin me makinën 'Volkswagen' me drejtues Jurges Gurthi, dhe pasagjer Egent Alku, ky i fundit me precedent të mëparshëm penal në fushën e krimeve kundër jetës.

LEXO EDHE:
Nesër moti i keq, pezullohet linja Durrës - Bari e anasjelltas dhe Vlorë - Brindizi e anasjelltas! Sarande-Korfuz do vijojë normalisht

Gjatë kontrollit në makinën e tyre u gjet një armë zjarri pistoletë me municion luftarak. Arma e zjarrit dhe municioni luftarak, së bashku me automjetin dhe 2 celularë, u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për veprime të mëtejshme.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 11:10
Balla bën 'bilancin': 29 të arrestuar e të vënë në hetim në kuadër të operacionit 'Tempulli' e 'Sundimi i Ligjit'

Ministri i Brendshëm, Taulant Balla ka bërë 'bilancin' e operacionit Tempulli dhe Sundimi i Ligjit në 72 orët e fundit. Ministri bën me dije se 29 persona janë arrestuar dhe vënë nën hetim në kuadër të këtyre operacioneve, në Durrës, Vlorë, Elbasan, Kavajë, Tiranë, Muriqan dhe Rinas.

Balla thotë se mbetet synim goditja e kultivuesve dhe shpërndarësve të lëndëve narkotike.

> *"Operacioni "Sundimi i ligjit" po largon çdo ditë nga komunitetet personat me rrezikshmëri të lartë, persona në kërkim apo ata të cilët posedojnë armë pa leje. Goditja e kultivuesve dhe shpërndarësve të lëndëve narkotike vijon çdo ditë, me qëllimin e mbrojtjes së shëndetit të të rinjve dhe çdo qytetari tjetër nga rreziku që sjell përdormi i tyre. Paketa e Sigurisë shkolla është e lidhur ngushtësisht me operacionin e Policisë së Shtetit "Tempulli", duke synuar pastrimin e perimetrit të sigurisë së shkollave nga shpërndarësit e drogës", shkruan Balla.*

Sl.E./Shqiptarja.com

Share

M.Q./Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: armëmbajtje pa leje | egent alku | jurges gurthi | Vlorë

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Jeni dakord me nismën e Kishës Katolike për ndalimin e simboleve komuniste?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Aeroporti i Vlorës, eksperti i aviacionit: Do ketë pistën më të mirë në Shqipëri, problem vetëm erërat e forta! Çoçoli: Vitin e parë priten mbi 1 milionë pasagjerë

29 Nëntor, 17:28

'Kitesurf' në Vlorë, flamuri kuqezi valëvitet mes detit

Armand Xhelili

29 Nëntor, 14:53

Sarandë/ U aksidentua gjatë natës dhe u largua pa pritur policinë, nën hetim punonjësi rumun i FRONTEX! Makina përfundoi e përmbysur në rrugë (FOTO)

29 Nëntor, 09:30

Mero Baze: Njeriu që kombi e ka lënë vetëm

Mero Baze

28 Nëntor, 18:38

111 vjetori i pavarësisë, Dredha: Rrugët e Vlorës janë plot, ka shqiptarë nga të gjitha trevat! Arifi: Lugina e Preshevës, një 'plagë', kërkojmë mbështetje

28 Nëntor, 17:26

Zyrtare/ Superliga në dyshim, Flamurtari zgjedh pasardhësin e Çelës! Në staf edhe Bicaj

28 Nëntor, 16:15

Përfshihet nga flakët një servis në Vlorë

28 Nëntor, 11:45

Rama: Bonusi për pensionistët shpërndahet këto ditë! Aeroporti i Vlorës përfundon brenda 2024! 21 Janari krim shtetëror, të përgjigjen ata që urdhëruan hapjen e zjarrit

27 Nëntor, 16:22

Dita e Flamurit/ Albin Kurti sot në Tiranë, nesër në Vlorë! Nuk komenton nëse do të takohet me Ramën

27 Nëntor, 15:35

Rama inspekton punimet në aeroportin e Vlorës: Në Shqipëri do të ngrihet një akademi për fushën e aviacionit

27 Nëntor, 15:24

Rama për Këshillin e Atlantikut: BE më e afërt me Ballkanin, por anëtarësimi i Shqipërisë do kërkojë kohë! Njohja e Kosovës, çështja më e madhe në rajon

27 Nëntor, 15:12

'28 nëntori', shqiptarët e Kosovës zgjedhin Vlorën: Festa e flamurit na bashkon çdo vit

Armand Xhelili

27 Nëntor, 13:52

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje